

Dr. Bedri MUHADRI

VEPRIMTARI E PERANDORIT JUSTINIANI I NË VENDLINDJEN E TIJ NË DARDANI

Të dhënat historike tregojnë se në trojet ilire, krishterimi është apostolik d. m th. se ai është pranuar direkt, e jo përmes rrugëve tjera e as nuk ishte i imponuar nga pushtimet e ndonjë perandori. Në literaturën sakrale pikërisht këtë e dëshmon apostulli Shën Pali ku shkruan “Kështu prej Jerusalemit e rreth e përfaqë deri në Ilirik e kam kryer plotësisht detyrën time të përhapjes së lajmit të gëzueshëm mbi Krishtin”. Me zyrtarizmi e krishterimit, sipas ediktit të Milanos, më 313, ku organizmi kishtar u legalizo edhe në trevën e Dardanisë, ky rajon mori frymën e zhvillimit institucional. Se Ilirët në Dardani kishin qenë të kristianizuar në kohën apostolike dëshmon edhe fakti se që nga zanafilla e organizimit dhe konstitucionit hierarkik kishtar, kishat ilire në Dardani ishin të pranishme në të gjitha çështjet dogmatike e disiplinore. Këtej përmes statusit të veçantë administrativ e juridik Dardania kishte edhe qendrën e ipeshkvisë ose mitropolinë të sanksionuar me Koncilin e Nikesë në vitin 325. Burimet antike, gjithashtu dëshmojnë se në provincën e Dardanisë gjendeshin dy vende të rëndësishme e të fortifikuara, Scupi dhe Ulpiana. Kështu, Kisha e Dardanisë do të jetë më vonë element i fortë i krishterimit dhe ruajtjes së etnikumit iliro-arbëror. Siç dihet, pas ndarjes së Perandorisë Romake në Lindje dhe në Përendim, më 395, iliriku Lindor në pikëpamje politike-administrative i përkiste Kostandinopojës¹ por, qendrat peshkopale në arealin e gjerë Ilire si Shkupi, Shkodra, Durrës, Nikopoja, mbetën në juridiksionin dhe ndikimin kishtarë të selisë më të lartë të Kryepeshkopatës së Papatit të Romës.² Gjatë shekujve IV-VI organizmin kishtar në Iliri mori hov të madh sa vetëm në Dardani u ngritën 5 deri në 7 ipeshkvi.

Në kohën e udhëheqjes së Dinastisë Dardane të Justinianëve Justini 518-527, Justiniani I 527-565 dhe Justini II 565-578 me Perandorinë Bizantine, filloj një jetë e re e besimtarëve dhe popullatës ilire në tërë territoret e sajë të gjëra e posaçërisht edhe në Dardani. Dinastia Dardane e Justinianëve ishte me origjinë Dardane, që vijnë nga dy fshatra fqinje dardane, fshati Bederiana vendlindja e Perandorit Justin dhe fshati Tauresium, vendlindja e Perandorit Justinian, të dyja këto fshatra gjendeshin në viset dardane

¹ Gasper Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, “Dituria”, Ferizaj, f. 42.

² Po aty, f. 42.

në qytetin e Shkupit.³ Prej shumë burimeve shkencore merret vesh se Dinastia e Justinianëve, janë dardanë nga Iliria. Kronisti antik Agathias-i vendlindjen e Justinianit e quan qytet ilir që quhej në kohë të vjetra Bedriana, por që më vonë u mbiquajt Justinian e Parë.⁴ Kronisti bizantin Precopi i Cezares-i thotë se “vendi prej nga vjen Perandori Justinian, është një qytet i dardanëve evropian, të cilët shtriheshin përtej kufirit të Durrësit shumë afër, përballë një vendi që quhet Bedriana, gjendej një vend i quajtur Tauris, prej nga vjen Perandori Justinian, themeluesi i botës romake....Dhe pranë këtij vendi, ai ndërtoi një qytet shumë të njohur Justiniana Prima, kështu ia pagoi hakun e ndërrueshmërisë shtëpisë që e krijoi atë”.⁵ Ky tekst i Prekopit, jep të dhëna të sakta dhe absolutisht të besueshme se vendlindja e Justinianit është Taeuresiumi në Provincën e Dardanisë.⁶

Ndër më të shquarit në mesin e perandorëve në histori njihet Perandori Justiniani I që udhëhoqi Perandorin Bizantine në vitet 527-565. Ai shquhet si reformator i madh i Perandorisë. Kështu në prill të vitit 529, nxori kushtetutën e re të Perandorisë, të njohur si Kodi i Justinianit “Codex Justiniana”. Gjatë kohës së tij nxori edhe kode të tjera ligjore, duke ia arritur qëllimit që ligjet t’i vinte në rregullim juridik. Vepra legjislative e Justinianit shënon fundin e periudhës së parë të historisë së të drejtës romake.⁷

Perandori Justinian, që njihet reformator i madh administrativ, juridik, po ashtu njihet edhe si reformator i madh kishtar. Ai luajti rol të rëndësishëm me autoritet të lartë mbi jetën e brendshme organizative kishtarë, duke nxjerrë dekrete të panumërta që rregullonin administrimin e manastireve, pozitën juridike të pasurive kishtarë, organizimin e trupës klerikale.⁸ Kujdesi i Justinianit ndaj Dardanisë ishte i jashtëzakonshëm çka mund të shihet nga ndërmarrja e ndërtimeve të tija. Pas tërmetit të madh shkatërrues të viti 518, në dokumentet kishtarë më nuk kemi lajme për Ipeshkvijtë në Dardani. Qytetet thuajse në Dardani ishin rrënuar pothuajse krejtësisht, sipas të gjitha gjasave shumica e banorëve ishin larguar për të shpëtuar jetën. Por, në saje të kujdesit të jashtëzakonshëm të Perandorit Justiniani 527-565, jeta në Dardani u rikthye dhe vazhdoi në qytetet e ripërtërirra dhe të ngritura.

Perandori Justiniani I, për të përballur më me suksese kundrejt sulmeve dhe invadimeve të popujve të njohur si barbarë në kufijtë e Perandorisë Bizanti, ai arriti që më përkushtim dhe suksese të dalluar të bëjë mbrojtjen

³ K. Frashëri, *E Vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrëmbërimet e Enciklopedisë së Shkupit*, Tiranë, 2010, f. 22-23.

⁴ *Ilirët dhe Iliria të autorët antik*, “Toena”, Prishtinë, 2002, f. 458.

⁵ Po aty, f. 438.

⁶ Qazim Lleshi, *Perandorët dhe dinjtarët ilirë II 518-578* “Dituria”, Tiranë, 1999, f. 72.

⁷ Q. Lleshi, vep. e cit., f. 60.

⁸ Ogyst Baji, *Perandoria e Bizantit (epopeja e një qytetërimi të magjishëm)*, “Arbëria”, Tiranë, f. 53-56.

nga këto sulme, duke marrë masa ushtarake, administrative, kishtare si dhe në krijimin e shumë veprave ndërtimore qofshin ato të rindëtuara pas tërmetit të vitit 518, apo edhe të ndërtuara rishtazi në territorin e Dardanisë, vepra këto që janë të shumta. Fakti që Justiniani ndërtoi dhe rindërtoi në Dardani në mes të shekullit VI më shumë se 158 kala, shumë më tepër se në provincat e tjera (në Epirin e Ri 58 kala; në Epirin e Vjetër 36 kala; në provincën maqedone 46 kala), tregon se në Dardani popullata vazhdon të ishte e dendur.

Kështu, në masat e ndërmarra kishtare perandori e riorganizoi kishën në Iliri dhe në këtë mënyrë krijoi një provincë të pavarur kishtare, së cilës i dha një rol të rëndësishme në këtë pjesë të Perandorisë. Deri në këtë kohë treva e Ilirikut në aspektin kishtar kishte një qendër, atë të Selanikut. Mirëpo, siç thotë studiuesi ynë i mirënjohur, G. Gjini “synimi i perandorit ishte i qartë, “që vendlindjen e vet ta ngrit në një qendër të re administrative e kishtare”.⁹ Kështu me vendimet e Perandorit Justinian qendra kishtare për pjesën e provincës së Dardanisë që ishte në kuadër të dioqezës së Maqedonisë, u bë Justinian Prima e ngritur në rang të mitropolisë.

Për këtë qëllim më 14 prill të viti 535 Justiniani e shpalli Novelën XI, e cila konsiderohet si statut i institucionit të dioqezës, përkatësisht vikariatit për këtë territori. Nën ekzarkatin e Justinianës së Parë do të jenë këto provinca: Dacia Maditeriana, Dacia Ripensis, Mysia e Parë, Dardania, Prevalitania, Maqedonia e Dytë dhe një pjesë e Panonisë së Dytë.¹⁰ territori i gjerë që në juridiksionin e vet do të ketë territore nga Serbia, Bullgari, Maqedonia, Malit të Zi dhe Kosovës.

Sipas, studiuesit G. Gjinit, del se akti i themelimit të Justinianës së Parë, nga ana e Perandorit Justinian, ishte pa ndonjë marrëveshje paraprake të precizuar me krerët kishtarë të Romës. Prandaj, Papa Agapi I (535-536), dërgoj në emision emisarët e tij, për njoftime dhe shqyrtim më të duhur për themelimin e Justinianës së Parë. Por meqë, nuk kemi reagime edhe nga ai dhe pasardhësi i tij Papa Silveri (536-537), lë të nënkuptohet se vendimet dhe autoriteti i Perandorit Justinian ishin të plotfuqishme edhe pse ai nuk ishte edhe sovrani supreme i Kishës. Por, dihet se Justiniani ishte shumë aktiv edhe në rrethanat nëpër të cilat organizohej kisha krishtere. Ai merrte pjesë dhe ndikonte në emërimet më të larta të hierarkisë klerikale, jepte aktdhurata për pronat e kuvendeve kishtare etj.

Më në fund, pas plotë dhjet viteve, statusi institucional dhe juridik i pavarësisë së Justinianës së Parë, u shpall dhe u zyrtarizua nga ana e Perandorit Justinian I, me aktin e nxjerrjes së Novelës CXXXI së vitit 545. Me këtë dispozitë të re, territori i vikariatit metropolitan të Justinianës së

9 G. Gjini, vep e cit., f. 44.

10 Po aty. 44.

Parë, ka ndryshuar dukshëm dhe është zvogëluar. Tani nën juridiksionin e mitropolitit të Justinianës së Parë hynë Panonia e Dytë, dhe provincat e përfshira në novelën e parë, por nuk përmendet më Macedonia Salutaris e cila bënte pjesë më parë. Me këtë akt perandori dëshiroi që t'ia rriste edhe më shumë autoritetin dhe pavarësinë kishtarë. Ndër masat e tilla juridike kishtarë, ishte se Ipeshkvi i Justinianës së Parë, pos titullit mitropolit, ai mbante edhe titullin e argjipeshkvit, që ishte e rangut të instancës më të lartë që do të vareshin disa krahina.

Argjipeshkvit të ri do t'i përkasë “summus honor, summa dignitas, summum sacerdotium, summum fastigium”, që do të thotë, nderi më i lartë, dinjiteti më i lartë, priftëria më e lartë, shkalla më e lartë.¹¹

Me këto parime, argjipeshkvisë do të përkasin jo vetëm nderi dhe primati, por edhe juridiksioni suprem në territorin e saj. Argjipeshkvi i Justinianës së Parë do t'i caktojë dhe shugurojë ipeshkvi të territorit të vet: njëkohësisht ai do të jetë edhe përfaqësues i drejtpërdrejtë i ipeshkvit të Romës të ipeshkvi i kësaj dioqeze.¹² Tani e tutje, as ai e as ipeshkvi që i nënshtrohen atij, për kurr gjë nuk do të varen nga ipeshkvi i Thesalonikut.¹³ Përveç kësaj, ai si epëror i dioqezës do t'i thërret, kryesoj dhe udhëheqë koncilët kishtarë provinciale. Do ta gjykojë dhe dënoj çdo konflikt dhe mosmarrëveshje që do të shkaktohet midis ipeshkvi të nënshtuar. Argjipeshkvin e ri do zgjedhin të gjithë mitropolitët dhe ipeshkvi të në kuvendin e përbashkët. Ata edhe do ta shugurojnë, ndërsa në krejt këtë ipeshkvi i Thesalonikut nuk bënë pjesë fare. Argjipeshkvi ka të drejtë që shumë çështje kishtarë t'i zgjidhë vetë drejtpërdrejt, ose përmes legatëve të vet, të cilët do t'i dërgonte sipas nevojës.¹⁴ Ndryshe nga pushteti i primatit vikariat, i cili më parë u jepej ipeshkvi të Thesalonikut vetëm herë pas herë, përkatësisht secilit titullar në mënyrë të veçantë, tani pushteti dhe juridiksioni iu dhe vetëm selisë së Justinianës së Parë.¹⁵

Kisha në atë kohë i kishte shumë borxh Perandorit Justinian, sepse ajo te ai e gjeti “jo vetëm mbrojtësin e zjarrtë, por edhe zotërinë e vet”.¹⁶ Dihet se Justinian edhe në dogmën kishtarë kishte pas ndikim të madh në përkrahjen e doktrinës kristologjike të konsupstancialitetit që përfaqëson njëqenësin e Krishtit me dy qeniet tjera hyjnore, Atin dhe Shpirtin e Shenjtë. Në frymën e kësaj Perandori Justinina, në vitin 531, shpalli ediktin me të cilët anatemizoheshin të gjithë ata që mohonin konsupstancialitetin e Krishtit.¹⁷

11 Gasper Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*. Dituria Ferizaj, 1992, f. 45.

12 Po aty, f. 45.

13 Po aty, f. 45.

14 Po aty, f. 45.

15 Po aty, f. 46.

16 Po aty, f. 46.

17 Po aty, f. 46.

Argjipeshkvi i parë i Justinianës së Parë merret Kateliani rreth vitit 535, ndërsa Gjoni si i fundit (591-602), del se kemi periudhën gjysmë shekullore të veprimtarisë së Argjipeshkvisë së Justiniana Prima.¹⁸ Kjo periudhë kohë përkufizohet me supozimin nga data e shpalljes së Novelës së Dytë 545 e deri te meshtari i fundit viti 602.¹⁹

Në këtë kohë popujt e ndryshëm barbarë, e më së shumti hunët dhe sllavët, filluan të depërtonin pandërprerë gjithnjë e më thellë duke i pushtuar këto anë e duke shkatërruar para vetes gjithçka, në rend të parë qytete dhe fortifikata. Sipas një shkrimi të vjetër²⁰ konsiderohet se qytetet dardane u pushtuan ose u rrënuan midis viteve 613-616, pra si argumenton G. Gjini, gjithsesi para rrethimit të madh të Selanikut në vitin 618, të cilin rrethimit e udhëhoqi Kagani.²¹

Ndonëse diskutimet ende të pazgjidhura për vendndodhjen e qendrës së zhdukur civile dhe kishtare të Justinianës së Parë, ku janë dhënë shumë pikëpamje për këtë vendndodhje të saj, po përmendim disa prej tyre. Prej mesit të shekullit XIX vendet e ndryshme supozohen dhe përmenden si vendndodhje e Justinianës së Parë; kështu për shembull: Shkupi, Prizreni, Ohri, Gjilani dhe Lebani afër Leskovcit.²² Mirëpo, tani ekzistojnë dy mendime kryesore dhe të kundërta. Sipas njërit at duhet kërkuar në trevën e Shkupit, ku identifikohet me Shkupin e sotëm, ndërsa sipas tjetrit at duhet kërkuar mbi Medvegjë te Lebana, buzë Luginës së Jablanicës, rrëzë masivit malor Gollak, në vendin e quajtur Cariçni Grad.²³ Sot përmendet më së shumti qyteti i Shkupit i cili njihej edhe si qyteti i Perandorit Justinian. Prokopi thotë: “Ai themeloi këtu (sc. Taurisiumit) pranë një qytet madhështor që e quajti Justiniana Prima”.²⁴ Ky shënim flet qartë se atë duhet ta lypim në mes të Bedrianës, për të cilën Prokopi thotë se e ka rindërtuar edhe Taurisiumin.²⁵ Në të mirë të ubikacionit të Justinianës Prima në afërsi të Taurisiumit pranë Shkupit të lashtë flasin edhe mbeturinat e ujës-jellësit të sotëm për të cilën Prokopi thotë: “Perandori ndërtoi këtu një ujës-jellës madhështor që të kishte ujë në të gjitha stinët”.²⁶

Këtë mendim e përfaqësoj studiues të njohur si Artue Evans, Zeilleri, Nikolla Vulić etj.²⁷ Këtij qëndrim i shkon edhe fakti i cili theksohet vazhdimisht, se Justiniana e Parë në aspektin kishtar ishte vetëm vazhdim

18 Po aty.

19 Po aty.

20 G. Gjini, vep. e cit., f. 46.

21 Po aty, f. 46.

22 Gj. Gjini, vep. e cit., f. 49 (shih fusnotën 17).

23 E. Dobruna, *Të dhënat mbi ndërtimet urbane të perandorit Justinian në trevën dardane*, Gazeta “Zëri”, 25 tetor 2008, f. 28.

24 *Ilirët dhe Iliria...*, f. 438.

25 Z. Mirdita, *Studime dardane*, “Rilindja”, Prishtinë, 1979, f. 140.

26 *Ilirët dhe Iliria...*, f. 438.

27 G. Gjini, vep. e cit., f. 49 (shih fusnotën 17).

i të dikurshmes "Ecclesiae Scupinae".²⁸ Selia e parë ipeshkvore në Dardani. me sa dihet deri më tani ka qenë në qytetin e Shkupit. Studiuesi Franja Barishqi. mendon se ajo duhet të jetë shtrirë në "një krahinë kufitare thrako-ilire". respektivisht qyteti gjendej në Dacia Mediterranea"²⁹, kurse Tomë Tomoski konsideron, se Justiniana Prima duhet të ubifikohet te Taurisiumi. te fshati i sotëm Tavor, jo larg Shkupit të lashtë. Këtë mendim e pranon edhe studiuesi Z. Mirdita.³⁰ Në Novelën XI të datës 14.IV. 535, që në thelb është dekret i karakterit institucional, thuhet: "Meqenëse aq fort dëshirojmë të lartësojmë me mënyra të ndryshme vendlindjen tonë (...) dëshirojmë që edhe për sa i përket pushteti kishtar ai të rritet në shkallën më të lartë kështu që drejtuesi shpirtëror i sotëm dhe i ndritshëm i qytetit tonë Justiniana e Parë të bëhet jo vetëm metropol, por edhe argjipeshkvi".

Po ashtu, shumë studiues mbi bazën e materialeve arkeologjike e identifikojnë Justinian e Parë me Cariqni Gradin, diku në afërsi të Krushumlisë.³¹ Studiuesi G. Gjini, në kundërshtimi të ubikacionit të Justinianës së Parë me Cariqin Gradin (vend afër Leskovcit në Serbi), sjell disa argumente. Largësia prej 100 kilometrave të zhvendosjes së qendrës së Argjipeshkvisë së Shkupit në Cariqin Grad, duke kapërcyer disa qendra të njohura ipeshkviale si Ulpiana e ndoshta edhe ndonjë tjetër.³² Shkupi si metropol nuk ka mundur e as ka guxuar të mbetet gjatë kohë pa epror, sepse këto ishin kohë shumë delikate përreth, veçanërisht në kufijtë verior të cilët ishin vazhdimisht të shqetësuar.

Gërmimet e deritanishme arkeologjike në Carqin Grad, padyshim kanë sjellë rezultate të lakmueshme. Gjashtë bazilikat e krishterimit të hershëm, flasin pikësepari për banorët shumë fetarë të këtij qyteti, por njëkohësisht është shumë e besueshme se kemi të bëjmë edhe me seli ipeshkvore. Monogrami i Justinianit në bazilikën me transept, është në gjuhën latine e jo greke. Edhe zbulimet e tjera të gjetura në Nish, Kumanovë, Priboj, flasin për faktin se në regjionin e Cariqin Gradit, gjuhë e liturgjisë ishte latinishtja. Edhe emrat e titullarëve të njohur të Justinianës së Parë (Catellianus, Benenatus, Johannes) tregojnë pa dyshim se i përkasin hapësirës gjuhësore latine.³³ Justiniana e Parë deri në prag të Luftës së Dytë Botërore, nga shumica e shkencëtarëve është lokalizuar në Shkup, ose në Ohër. Ndërkaq nga gërmimet që u ndërmorën në vitin 1936-1938, u zbuluan rrënojat e lokalitetit, që u quajt nga studiuesit serb "Cariqni Grad" e që gjendet midis qyteteve Leban dhe Medvegjë, përkatësisht në gjysmë

²⁸ Po aty, f. 46.

²⁹ Zef Mirdita, vep e cit., f. 130.

³⁰ Po aty.

³¹ G. Gjini, vep e cit., f. 47.

³² Po aty.

³³ Po aty.

të largësisë rrugore Leskovc-Prishtinë.³⁴ Në përpjekje për të lokalizmit të Justinianës së Parë, në disa shkrime këtu në Kosovë, vështruar në aspektin topografik, vendndodhja e Justinianës së Parë që vendosur në një luginë të thellë lumore të Jablanicës, rrëzë masivit Gollak, pikërisht në masivin malor të Lebanës. Ky region, sikundër ishte përgjithësisht i banuar më popullatë shqiptare.³⁵

Megjithatë, Justiniana Prima në këto periudha të vullshme, plot turbullira dhe pasiguri, si pasojë e dyndjeve të pandërprera të popujve të ndryshme barbarë dhe sllavëve, nuk do të qëndrojë gjatë. Ajo përmendet për herë të fundit në aktet kishtare në vitin 602, kur Gjoni, arqipeshkvin e saj përipiqet ta ndërrojë Perandori Maurik (582-602). Kundër dëshirës autokratike të këtij perandori angazhohet papa i Romës, Gërguri i Madh.³⁶ Nga kjo shihet qartë se Justiniana e Parë, edhe i tërë territori administrativ i Mitropolisë dhe i argjipeshkvisë gjendet nën juridiksioni e Kishës së Romës. Kjo mund të shihet qartë nga korrespondenca e Papës Gregurit të Madh, letrat e të cilit adresohen për Gjonin, argjipeshkvin e përmendur dhe kanë të bëjnë me mosmarrëveshje në mes ipeshkëv Palit dhe Nemesiut përkitazi me selinë ipeshkvore të Diokletianës. Nga kjo korrespondencë kuptohet se ai mbetet ende drejtues suprem kishtar i këtyre viseve, përkundër kundërshtimit të perandorit Maurik.³⁷ Veç kësaj, Argjipeshkvi Gjoni është i fundit që përmendet si udhëheqës i Justiniana Prima.³⁸ Pas krejt ç'u tha shtrohet me të drejt çështja e kontinuitetit kishtaro-administrativ të ipeshkvisë së Shkupit të lashtë e Justinianës së Parë dhe kontinuitetit i këtyre të dyjave në ipeshkvin e sotme të Shkupit. Në bazë të fakteve historike të interpretuara nga studiues të njohur, e pohojnë bindshëm kontinuitetin kishtaro-administrativ të ipeshkvisë së Shkupit të lashtë dhe Justinianës së Parë.³⁹ Lidhur me këtë, një fakt i sigurt i bashkon ato, kjo është pozita e tyre nën juridiksionin e papatit përkatësisht lidhja apo bashkimi i përhershëm i tyre me Kishën e Romës.

Veç kësaj edhe vet fakti që Justiniani e ndërton Justiniana Prima dhe e ngriti atë në aspektin kishtar në rang të argjipeshkvisë dhe të mitropolisë me të gjitha prerogativat e përmendura, bile pas jo më shumë se 27 vjetëve pas tragjedisë që e kaploi këtë tërmeti katastrofal, besojmë se ai do të ketë pasur një bazë në sajë të së cilës ka qenë i detyruar të vepronte. Sepse dihet se pas tërmeti shkatërrues të viti 518 dhe nga ana tjetër sulmet dhe dyndjet e pandërprera të barbarëve dhe sllave Shkupi i lashtë nuk përmendet më.

34 Q. Lleshi, vep e cit., f. 74.

35 Po aty, 74.

36 G. Gjini, vep e cit., f. 47.

37 Po aty.

38 Po aty.

39 Po aty.

Qytete dhe fshatrat shkretohen. Në sajë të dhënave të autorëve të ndryshëm shihet se këto vise i kishin okupuar fiset e ndryshme sllave. Popullata së bashku edhe me priftërinjtë ikën në vende më të sigurta. Në këto kohë tragjike, nga një anë katastrofave natyrore dhe nga ana tjetër dyndjet e pandërprera barbare dhe të sllavëve, në fronin ipeshkvor të Shkupit përmendet Gjoni, ipeshkvi për fatin e të cilit nuk dihet asgjë.⁴⁰ Duke marrë parasysh që Justiniana e Parë qe themeluar si qytet krejtësisht i ri në të tretën e parë të shekullit IV vit 535, por që në epokën e qeverisjes së Perandorit Heraclius I (610-641) pushoi së ekzistuari, pra deri kur vërshimi sllav e tronditi thellë territorin bizantin, duke u shkatërruar dhe humbur shumë qytet e në mesin e tyre edhe Justiniana e Parë.⁴¹ Që këtë del se Justinian e Parë, nuk do të ketë jetuar më shumë se një shekull. Pra, për një kohë kaq të shkurtër, zgjerimi i saj i konsiderueshëm territorial me godina monumentale, fetare dhe profane, mund të shpjegohet me faktin e pamohueshëm se vërtet është fjala për një qendër shumë të ngritur në atë kohë të njohur Justiniana e Parë, në territorin e Dardanisë.

Ndërmarrje tjetër e rëndësishme në Dardani nga ana e Perandorit Justinian ishte ndërtimi i qytetit tjetër, që njihet Justiniana Secunda. Lidhur me këtë qendër na njofton Prokopi i Cezares i cili thotë: "Ka pasur në Dardani, që prej kohëve të lashta, një qytet që quhej Ulpiana (Ulpiana). Ai (Justiniani) rrëzoi pjesën më të madhe të murit të saj rrethor, i cili qe dëmtuar shumë me rastin e tërmetit 518 dhe nuk shërbente për asgjë, dhe bëri një mur rrethues, i rindërtoi që të gjitha dhe pasi e stolisi me madhështi dhe i dha bukurinë e sotme, i vuri emrin Justiniana Secunda-Justiniana e Dytë".⁴²

Ky qytet, si trashëgimtar i Ulpianës; vazhdoi të jetë qendër me rëndësi ipeshkvore, por tash nën argjipeshkvin e Justinianës së Parë.⁴³ Ulpiana, apo Justiniana e Dytë ndodhet në rajonin e pasur me xehe me ngjyra (plumb, zink, argjend) që do të ketë qenë edhe një qendër banimi shumë e zhvilluar ekonomike për dardanët.

Si përfundim, shekulli VI mbizotërohet nga personaliteti i Perandorit Justiniani I, kurse sundimi i tij shënon pikën kulmore të Perandorisë së Romës. Po ashtu me këtë Perandor, shfaqet një rilindje ekonomike, politike në provincën e Dardanisë, në vendlindjen e tij, duke ngritur qytete të mëdha dhe me institucione më të larta në kuadër të principatave të Perandorisë së tij.

40 Z. Mirdita, vep. e cit., f. 136.

41 Q. Lleshi, vep. e cit., f. 74.

42 *Ilirët dhe Iliria të autorët antik*. "Toena", Tiranë. 2002. f. 439.

43 E. Dobruna, vep. e cit., f. 28.

Dr. Bedri MUHADRI

SUMMARY

**THE EMPEROR JUSTINIAN ACTIVITY IN HIS
HOMELAND DARDANIA**

One of the most prominent Emperors in history Justinian led the Byzantine Empire in 527-565 years. Also, he was known as the great reformer of the empire. In April 529, Justinian adopted the new constitution, known as the Code of Justinian "Codex Justiniana". During his reign were also brought other legal codes, accomplishing its goal to put laws in the judicial framework.

In order to cope and repel successfully the incursions and invasions of barbarian peoples at the borders of Byzantium Empire, determined Justinian I managed with outstanding sensation to defend against assaults, undertaking military, administrative, and ecclesiastical measures, offering more prosperity, construction works, and rebuilding after the earthquake of 518, or even by other numerous works in the territory of Dardania. Thus, Emperor's reforms reorganized the church in Illyria establishing an independent ecclesiastical province, which later provided an important role in this part of the Empire. In 535 the decisions of Emperor Justinian on the ecclesiastical center of the province of Dardania which was the part of the diocese of Macedonia, became Justiniana Prima promoted in the level of metropolis.

Institutional and legal status of the Justiniana Prima's independence was declared and formalized in 545, by the Emperor Justinian I, enacting the Novel CXXXI.

By these acts, the archbishops would expand supreme jurisdiction in the territory. The archbishop of Justiniana Prima assigned and baptized bishops of its territory, simultaneously being the direct representative of the bishop of Rome to the bishop of the diocese. Onwards, neither he nor the bishops subjected to him, would be dependent on the bishop of Thessalonica.

At the time of the Emperor Justinian I, a renaissance of economical and political character flourished in the province of Dardania, his birthplace, with construction of large towns and high level institutions within principalities of the Empire.